

Fjalim i Zahir Tanin
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe Shef i UNMIK-ut
Forumi i Kombeve të Bashkuar për Ndërtimin e Besimit në Kosovë
6 maj 2018
Lubjanë, Slloveni

Mirëmbërëma mysafirë, miq dhe kolegë të nderuar,

Kam kënaqësinë t'ju mirëpres gjithë ju në Forumin e Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Besimit në Kosovë. Ju falënderoj që gjetët kohë të na bashkoheni këtu në Lubjanë dhe ju falënderoj për dedikimin tuaj për Kosovën dhe për ndërtimin e besimit në mes të gjitha komuniteteve. Përshëndes gjithashtu për zemërsisht Asistentin e Sekretarit të Përgjithshëm Bintou Keita, dhe kolegët e mi nga Kombet e Bashkuara të cilët na janë bashkuar nga e gjithë Kosova, duke përfshirë ekipin e KB-së nga Kosova, Beogradi dhe Nju Jorku. Dua të falënderoj edhe miqtë tanë nga Bashkimi Evropian, EULEX-i dhe natyrisht OSBE-ja.

Sot, gati 19 vjet nga kulmi i konfliktit, bashkësia ndërkombëtare vazhdon të mbështesë paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë. Duke qenë nën ombrellën e njëjtë ligjore, të gjitha organizatat janë të mandatuara dhe vazhdojnë të jenë të zotuar për të punuar në trajtimin e sfidave reale me të cilat përballet Kosova, jo thjeshtë në negociatat politike por edhe në nivele më të thella – duke nxitur marrëdhëniet në mes të njerëzve dhe grupeve të bashkësive.

Ky takim mbledh një grup të veçantë të liderëve të shquar, duke përfshirë ata që tanimë kanë arritur rezultate dhe ata të cilët do të marrin përgjegjësi. Jemi bashkuar për t'i kontribuar fuqizimit të themeleve të një paqeje të qëndrueshme dhe një shoqërie stabile e të qëndrueshme. Ne nuk jemi këtu në tavolinën e

negocimit. Dialogu politik i lehtësuar nga BE-ja, që synon normalizimin e marrëdhënieve dhe arritjen e marrëveshjeve politike në mes të Prishtinës dhe Beogradit, nuk është fokusi ynë këtu.

Ne jemi këtu për të identifikuar se si, në nivelin shoqëror, atë të bazës, liderët komunalë, shoqëria civile dhe komunitetet e Kosovës mund të avancojnë besimin e qëndrueshëm dhe bashkëpunimin e ndërsjellë për të ardhmen e tyre. A mund të ndihmojnë ne në ndërtimin e besimit dhe një të ardhmeje që u përket të gjithëve? Ne jemi këtu sepse besojmë se përgjigjja është po, por pyetja kryesore mbetet si? Mosbesimi në mesin e shumë komuniteteve në Kosovë akoma ndan shumë njërës, dhe i parandalon ata në shqyrtimin e përpjekjeve të përbashkëta që synojnë ndërtimin e një platforme të përbashkët shoqërore, dhe jo në çarmatosjen e njëanshme të palës tjetër. Ngulitja e konfliktit dhe valët pasuese të dhunës qëndrojnë gjatë në mendjet e njerëzve dhe vazhdojnë të ndërlikojnë ecjen përpara. Edhe gjenerata e re, në pjesën më të madhe, nuk është në gjendje ta lirojë veten nga bartja e perceptimeve të trashëguara të kohës së konfliktit dhe dhunës që ndodhën përpara se ata të lindnin apo të mund të ishin pjesë e armiqësive. Siç e dimë, historia e humbjes së jetës, e dëbimit nga shtëpitë dhe trauma e vazhdueshme, nuk mund lehtëzi të lihen anash. Njerëzit i kanë mendimet e tyre, perceptimet dhe përvojat - ata nuk janë thjeshtë spektatorë të konfliktit. Kur shpërthen luftë apo konflikt, ajo merr formë në “trupin e shpirtligëve të ndryshëm”, zhurma e luftës e shurdhon arsyen, dhe njerëzit ndahen për shkak të pikëpamjeve të tyre dhe interpretimit të konfliktit. Kjo është uzinë e mosbesimit.

Nëse organizimi i jetës politike dhe sociale pas konfliktit nuk e trason apo nuk mund ta trasojë rrugën për një të ardhme të pranueshme për të gjithë, do të jetë e vështirë t'u mundësohet njerëzve të ekzistojnë, të jetojnë, të gjejnë konturat e një

bashkëjetese të re të bazuar në një marrëveshje të pranueshme të pajtueshme për të gjithë. Puna e këtij Forumi dhe takimet e shumta që janë mbajtur vitin e kaluar dhe veçanërisht ato të grupeve të fokusit gjatë dy muajve të kaluar, do të na mundësojnë ne të identifikojmë dhe më mirë të artikulojmë çështjet e marrëveshjes, të deshifrojmë zonat e mosmarrëveshjeve dhe të bashkojmë nevojat dhe reagimet në mënyrë koherente, ku pranimi, ndjeshmëria dhe kuptimi do të ndihmonin për t'i bashkuar të gjithë. Pa zbulimin dhe projektimin e një rruge për ecjen përpara, pak njerëz do të jenë në gjendje të jetojnë në paqe dhe prosperitet, qoftë në një periudhë të shkurtër apo të gjatë kohore. Vështirë do të jetë tejkalimi i ndikimit të një të kaluarë të mbushur me dhimbje, dhe qetësimi i shpirtave të njerëzve të ndikuar nga konflikti, por objektivi i këtij Forumi është të krijojë një agjendë të tillë, një kornizë të realizueshme për të ndërtuar besimin dhe për të ndihmuar drejtimin e së ardhmes. Një kornizë e tillë duhet të përfshijë faktorët shoqërorë, politikë, kulturor dhe ekonomikë; të gjitha fushat me përfitim dhe interes reciprok. Fokusi ynë është në ndërtimin e besimit të vazhdueshëm e të qëndrueshëm në mes të gjitha grupeve të njerëzve që jetojnë në Kosovë, të kthejmë marrëdhëniet normale në mes të grupeve. Kjo është e domosdoshme, meqë pa pajtim shoqëror dhe ndërtim të besimit, përfshirjen e njerëzve, komuniteteve dhe të shoqërisë civile, përkundër përpjekjeve më të mira dhe qëllimeve fisnike për përfundimin e luftërave dhe konflikteve, një situatë jostabile lehtë mund të bëhet kritike dhe të shpie në humbje të ekuilibrit të stabilitetit.

* * *

Sot spektri i kobshëm i luftës dhe konfliktit vazhdon të trazojë globin. Nga Ukraina deri në Sudanin e Jugut, nga Kolumbia deri në Libi, nga Siria deri në Jemen, nga Iraku deri në Afganistan dhe tutje, ne shohim brutalitetin e një epoke të

katastrofës. Gjatë tri dekadave të fundit, shumica prej jush në këtë sallë, duke përfshirë edhe veten time, kemi jetuar në kohëra të turbullta, të cilat vetë i kemi përjetuar dhe nuk i kemi mësuar nga librat apo studimet. Ne kemi përjetuar tragjedi, jemi rritur në një epokë traumatike, dhe deri në këtë moment kemi mbijetuar! Për ne, kjo ndonjëherë ka qenë dekurajuese, tronditëse dhe e dhimbshme.

Më lejoni të ndajë me ju vrotimet dhe ndjenjat e mia me pak fjalë: U linda në kohë të paqes, u rrita në kohëra të stuhishme, arrita moshën madhore në luftë dhe tani po plakem në një atmosferë të konfliktit të pafund në vendlindjen time dhe gjetiu. Kam jetuar gjatë një sërë luftërash në Afganistan, invadimi sovjetik, dhe u largova nga vendi kur ekstremistët e morën pushtetin. Valët e luftërave të brendshme i shkatërruan njerëzit, vendin dhe shtetin. Kam përjetuar arrestimin, torturën dhe kam vuajtur në faza të ndryshme të luftës dhe konfliktit. U bëra person i zhvendosur dhe i pastrehë; humba çdo gjë që posedoja; u bëra refugjat; i pranuar nga një shtet tjetër; të gjitha për shkak të përpjekjeve të mia të pareshtura për të raportuar, për të shkruar dhe për të luftuar si pjesë e përpjekjeve më të mëdha për kthimin e normalitetit në vendin ku jetoja. Ju bashkova përpjekjeve për t'i dhënë fund luftës së vazhdueshme dhe për të bashkuar të gjitha grupet pas vitit 2001, me shpresën për paqe të qëndrueshme në një vend që pësoi shkatërrim të pafund. Përkundër përpjekjeve tona më të mira, unë jam dëshmitar, tash sërish, të kthimit të një lufte të pandërprerë. Unë vuaj, duke menduar nëse do të jetoj aq gjatë apo jo sa të shoh paqe dhe stabilitet në vendlindjen time. Qëllimi im është të theksoj se e kuptoj çdo të thotë t'i mbijetosh fatkeqësisë dhe vështirësitë që duhet tejkaluar për ndërtimin e besimit në një shoqëri pas tragjedisë. Unë e kuptoj dhimbjen të cilën njerëzit në këtë sallë mund ta kenë përjetuar. Këtë e them me gjithë zemër.

* * *

Mysafir dhe miq të nderuar,

Lufta dhe konflikti nuk janë vetëm përvoja personale. Është me rëndësi të dimë si luftërat dhe konfliktet i prekin njerëzit dhe si njerëzit kolektivisht mund të kontribuojnë në formësimin e një të ardhmeje ndryshe. Më lejoni të filloj me një deklaratë që është e evidente. Konfliktet e fundit në Ballkan u nxitën gjatë shkatërrimit të Jugosllavisë në vitet e 80-ta dhe 90-ta. Paradoksalisht, situata u pasua me rënien e murit të Berlinit dhe fundin e Bashkimit Sovjetik, në një periudhë të optimizmit të ri, të cilën disa madje e përshkruan si “fundi i historisë”. Kjo mospërputhje tronditi shumë njerëz; iluzionet e konfliktit ishin ankthi i Evropës, kontrast i plotë i shpresave të idealizuara pas rënies së bllokut komunist. Natyrisht, shumë faktorë i kontribuan shpërthimit të luftërave në Jugosllavisë, duke përfshirë krizën e pushtetit qendror federal, rritja e nacionalizmit dhe etno-nacionalizmit dhe mos-stabiliteti ekonomik, dhe unë nuk do të përpiqem të ritregoj kompleksitetin e kësaj historie. Ajo çka ndoshta është më e rëndësishme sot është të potencohet se ideologjitë e së kaluarës, siç janë krijimi i shtetit brenda kufijve etnik dhe nacional, nxiti lëvizje të reja nacionaliste, dhe se nacionalizmi etnik u bë forca esenciale mobilizuese e shumë luftërave. Ky model përsëritet në shumë tranzicione postkomuniste dhe në zona të konfliktit gjatë 30 viteve të fundit. Natyrisht, disa keqinterpretime të zakonshme nga jashtë ju ngarkuan luftërave të Jugosllavisë duke i quajtur “Logjikë unike e Ballkanit” – të qenurit “ndryshe” e Ballkanit, me perceptimin e gabuar duke e parë rajonin pa përvojë dhe jo të gatshëm për tolerancë. Këto mendime paragjyquese pohuan se rajoni “nuk ishte në të vërtetë” Evropë dhe se “këta njerëz” e kishin vrarë njëri

tjetrin përgjatë historisë së tyre. T'i kuptosh këto luftëra pa paragjykime të thjeshta është jetike të njohësh si funksionon etno-nacionalizmi, dhe të pranosh se etniciteti është bërë një mjet i spikatur i politikës, posaçërisht në epokën pas luftës së ftohtë.

* * *

Ashtu siç e kam përshkruar, lufta dhe trazira shkaktojnë dhimbje, urrejtje dhe shkatërrimin e marrëdhënieve njerëzore. Konflikti e shtrembëron të kaluarën, e rrit mostolerancën. Përderisa ne nuk mund ta injorojmë historinë, ajo çka është më e rëndësishme është se si ne e pranojmë dhe e kuptojmë atë në mënyrë të sinqertë. Ne duhet të sigurojmë që atë të mos e reinterpretojmë në dëm të së tashmes dhe të ardhmes tonë. A kaluara ndonjëherë duket e pakthyeshme, por e ardhmja akoma mund të imagjinohet dhe të përcaktohet. Përderisa është gabim të ftosh njerëz thjeshtë për t'u thënë ta harrojnë të kaluarën, është e drejtë t'u bësh thirrje për mundësinë e një jete të përbashkët më të mirë dhe një të ardhme të përbashkët.

Luftërat dhe konfliktet vazhdojnë dhe zgjasin, çuditërisht në një kohë kur njerëzimi arriti në kulmin historik të teknologjisë dhe aftësive për të formësuar botën. Ky është paradoks që kërkon një mençuri kolektive dhe lidërsip për ta zgjidh. Përkundër hapave globale për ecjen përpara, nacionalizmi etnik është bërë njëri prej faktorëve kryesor politik që çon në trazira dhe sfidim të stabilitetit në mbarë botën. Në historinë tonë moderne, faktorët nacionalist dhe etno-nacionalist ishin përtej konflikteve të shumta mizore që bënë shkatërtime, rrënime dhe tragjedi.

Një studim i fundit i rëndësishëm ka arritur në konkludimin se vetëm 20% e luftërave ndërmjet 1815 dhe 1919 ishin pasojë e etno-nacionalizmit, afërsisht 50%

e luftërave nga 1919 deri në fillim të shekullit 21 rrënjët i kishin në etno-nacionalizëm. Në periudhën që nga kolapsi i Bashkimit Sovjetik, 75% e të gjitha luftërave dhe konflikteve janë klasifikuar në masë të madhe si etno-nacionaliste për nga karakteri. Siç mund ta shohim, ndikimi i etno-nacionalizmit dhe nacionalizmit në Evropën moderne është historik. Siç është thënia, “Llogaritë e Luftës së Parë tani duhet paguar”. Jo vetëm në Evropë por edhe në Lindjen e Mesme, me rrëzimin e Perandorisë multi-etnike të Hapsburgut, asaj Otomane dhe Ruse në vitin 1917-18, kjo u mishëruan në natyrën e marrëveshjeve pas konfliktit. Siç ka theksuar një historian, esenca e këtij tranzicioni ishte ideja Vilsoniane (Wilsonian) e “vetëvendosjes,” që determinoi riformësimin e Evropës, dhe në mënyra të ndryshme Rusinë dhe Lindjen e Mesme, në shtete territoriale etno-linguistike. Teoria Leniniste e kombeve, mbi të cilën u krijua Bashkimi Sovjetik dhe më vonë Jugosllavia, në esencë ishte po ashtu i njëjtë. Si pasojë, që nga 1989, ne kemi parë krijimin e 16 shteteve të reja nga mbetjet e ish Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë.

Këtyre ditëve, lehtë mund të shihet politika e identitetit në kombinim me aktivitetet etno-religjioze të Xhihadistëve Islamik dhe të tjerëve në Lindjen e Mesme, Afrikën Veriore dhe në pjesë tjera të botës. Në anën tjetër, diversiteti etnik jo domosdoshmërisht rezulton me luftë, siç mund të shohim nga prania e grupeve të shumta etnike të ndryshme në Evropë, me një popullatë të përgjithshme mbi 100 milion, të cilët e kanë gjetur një mënyrë për bashkëjetesë paqësore dhe prosperitet. Ka edhe shumë shembuj të tjerë rreth botës. Kjo po ashtu tregon se politika e identitetit mund të menaxhohet paqësisht nëse arrihet konsensus për tregimin e përbashkët të së kaluarës, së bashku me një vullnet të fuqishëm për jetesë të përbashkët.

Cila është zgjidhja për trajtimin e ndikimit destruktiv të nacionalizmit etnik derisa arrijmë në këtë fazë të “konstalacionit post-nacional”? Që të krijojmë një shtyllë për bashkëjetesë, një botë në ndryshim e sipër kërkon të menduarit ndryshe për një epokë të re. Në disa pjesë të botës ne shohim se si qasja e barazisë, ku ruhen të drejtat e barabarta dhe identitetet e ndryshme, përkatësisht gjuha dhe religjioni, ka pas sukses. Kjo pikëpamje qartazi ka qenë më efektive, më mirë se trajtimi forcërisht i dallimeve, me organizimin e një “grupi” apo “grupeve” me qëllim të çorganizimit të tjetrit. Menaxhimi i dallimit përmes mënyrave të pranueshme për njerëzit, duke përfshirë integrimin, mund të jetë komplekse, por i realizueshëm, dhe unë besoj se qeveritë duhet të përqendrohen në këtë. Dua të potencojë tendencën bashkëpunuese të madhe që e ka njerëzimi, që nuk duhet të nënvlerësohet përkundër fakteve historike të brutaliteteve dhe mizorive që i kanë bërë shumica.

* * *

Zonja dhe zotërinj,

Arritja e pajtimit shoqëror pas konfliktit mund të jetë edhe më i vështirë sepse marrëdhëniet në mes të grupeve janë prishur rëndë, për të mos përmendur rrënimin e institucioneve. Lëvizja nga pajtimi shoqëror në rritjen e besimit, në radhë të parë kërkon pranimin e të drejtave të të gjithë individëve për të bashkëjetuar. Nëse toleranca dhe kompromisi nuk mund të arrihen lehtë pas konfliktit, ata mund të promovohen në kuadër të procesit të ndërtimit të besimit. Korniza e ndërtimit të besimit duhet të përqendrohet në nxitjen e kuptimit dhe fuqizimit të mjeteve për zgjidhjen e konfliktit. Ekzistojnë objektiva të arritshme kur njerëzit fillojnë të shikojnë kah e ardhmja dhe e lirojnë veten nga barra e së kaluarës. Rritja e besimit në mes të grupeve kërkon besim të fuqishëm në nevojën për pajtim dhe shpesh

edhe perspektivën për një kornizë më të madhe për të punuar së bashku, duke përfshirë në mes tjerash fuqizimin e institucioneve demokratike, zgjedhje të lira dhe të drejta, ndarje të pushtetit, qeverisje dhe shërbime të mira, administrim të drejtësisë dhe sundim të ligjit, respektim për të drejtat e njeriut dhe diskurs të kuptueshëm.

Leksioni kryesor i rëndësishëm nga të gjitha konfliktet është se si të sigurohemi që marrëveshjet politike nuk do të përfundojnë thjeshtë si guaska të zbrazëta, duke e lënë konfliktin të gatshëm për t'u rinisur në çdo kohë. Bazuar në atë çka kemi mësuar nga përvojat tjera globale, nxitja e pajtimit shoqëror dhe ndërtimi i besimit janë thelbësore për sigurimin e mospërsëritjes së konfliktit të dhunshëm. Një shembull i cituar gjithandej për këtë është Korniza e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në Afrikën e Jugut, një shmangie nga koncepti i Nuremberg-ut për “drejtësinë e fitimtarit” pas Luftës së Dytë Botërore. Ky model i ri u përqendrua në dëmshpërblim dhe jo në hakmarrje përballë të kaluarës së dhunshme, duke ofruar parimin e mirënjohur “fal por mos harro”.

Në të vërtetë, më të rëndësishme ishin negociatat që i dhanë fund regjimit të Aparteidit, Konventa për Afrikën Demokratike të Jugut (“CODESA”), që i parapriu Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin. Profesori i Universitetit të Kolumbisë Mahmood Mamdani, në analizën e tij të detajuar, potencoi se “çelësi për tranzicionin pas Aparteidit nuk ishte shkëmbimi i amnistisë për të vërtetën por amnisti për gatishmërinë për reformim”. Reforma qendrore ishte ajo që çoi në rrugën përpara, juridikisht dhe politikisht pas Aparteidit. Mamdani theksoi se negociatat e CODESA ndryshuan pikëpamjet e ish luftëtarëve dhe çuan në përparim larg kriminalizimit apo demonizimit të “tjetrit”, duke e trajtuar tjetrin si kundërshtar politik në mënyrë paqësore. Kjo nënkuptonte që të dy palët të lëviznin

nga më e mira në alternativën e dytë më të mirë për të dy palët në konflikt. Sipas mendimit të Mamdanit, ky evolucion kishte të bënte me forma të ndryshme të drejtësisë dhe të pajtimit, ato kriminale, politike dhe shoqërore. CODESA, në realitet, i dha prioritet drejtësisë politike që u përqendrua tek grupet e prekura, kurse drejtësia penale në shënjestër kishte individë. Kjo i mundësoi Afrikës së Jugut të largohet nga Aparteidi duke i kthyer armiqtë në kundërshtarë politikë. Pikëpamja e Mamdanit për fokusim në drejtësinë politike dhe sociale mund të sigurojë një bazë të dobishme për prioretizimin e së ardhmes.

Mysafir të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Megjithatë, nëse njerëzit nuk duan të shkatërrojnë të ardhmen e tyre, është më me rëndësi që ata të riaktivizojnë fokusin në ndërtimin e besimit para se të krijojnë tregimin e përbashkët të historisë. Për Kosovën, dhe përgjithësisht për Ballkanin Perëndimor, mund të jetë akoma herët për të arritur marrëveshje për tregimin e përbashkët të historisë. Fokusi tani është në të ardhmen dhe në ndërtimin e një bazamenti më të mirë për të ardhmen.

Bota është mjaft e madhe për të jetuar së bashku dhe për të bashkëjetuar. Ne kemi përgjegjësi për të siguruar që fëmijët tanë nuk do të kalojnë nëpër momentet e dhunshme të cilët ne i kemi përjetuar. Më lejoni të ritheksoj se ekziston një marrëdhënie e brendshme në mes të mposhtjes së mosbesimit dhe ndërtimit të besimit, nëse krijohen kushtet dhe mekanizmat janë në dispozicion. Një hap i rëndësishëm për tejkalimin e mosbesimit do të ishte menaxhimi më i mirë dhe jo kërkimi i eliminimit të dallimeve, qoftë në mes të komuniteteve shumicë apo atyre joshumicë, të mëdha apo të vogla.

Është sfidë e madhe të gjendet ekuilibri në mes të paqes dhe drejtësisë në të gjitha situatat pas konfliktit. Por për të shmangur kthimin në konflikt dhe dhunë, përgjigjja e vetme është të krijohet një klimë shoqërore e favorshme për të kuptuar më mirë, për të përkrahur dialogun në mesin e të gjitha grupeve, duke i kthyer armiqte në rivalë politik apo edhe në partnerë, bazuar në pranimin e nevojave, të drejtave dhe obligimeve reciproke, dhe drejtësia të trajtohet në kuptimin më të gjerë: penale, politike dhe sociale. Bashkësia ndërkombëtare ka ndihmuar njerëzit dhe komunitetet e Kosovës në marrjen e hapave të rëndësishëm pas kulmit të konfliktit: përkrahjen e dialogut, arritjen e mirëkuptimit, krijimin e strukturave bazike për paqe, avancimin e aktiviteteve bashkëpunuese dhe shumë të tjera. Tani është koha që këto përpjekje t'i çojmë në një nivel të ri.

Ne sot së bashku nisim një iniciativë për krijimin dhe definimin e një kornize për besim dhe bashkëpunim. Ne jemi këtu të përkrahim dhe avancojmë këtë përpjekje. Por, ju jeni njerëzit me fuqinë për ta jetësuar këtë. Lidërshipi është i domosdoshëm për sukses. Udhëheqja me ndjeshmëri, kuptim dhe qartësi është ajo që nevojitet për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë, një të ardhmeje që mund të formësohet vetëm nga ju. *Është koha të organizojmë të ardhmen dhe jo thjeshtë të vajtojmë të kaluarën!*